



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FINIQ-DROPULL

Nr. 604 prot.

Finiq, më 18.09.2023

NJOFTIM PËR PUNËSIM

Në mbështetje të Ligjit 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Urdhërit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 31, datë 28.01.2020 “Për Miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore”, Udhëzimit Nr. 17, datë 26.07.2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin Nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 14, datë 10.7.2023 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar” si dhe Urdhërit nr.531, datë 09.09.2022 të MAS “Për përcaktimin e planit mësimor për pakicat kombëtare në arsimin bazë.

ZVAP FINIQ - DROPULL

NJOFTON:

Kërkesën për personel mësimor si më poshtë:

SHMB "Lefter Talo" Livadhja, profili Gjuhë Angleze. Pozicioni i punës përmban 20 orë, nga këto të detajuara 11 orë profili Gjuhë Angleze dhe 3 orë Muzikë, 4 orë fiskulturë (kurrikulë greqisht), si dhe 2 orë kujdestari.

Kontratë: Me afat të caktuar, deri në përfundim të vitit shkollor 2023-2024, (me të drejtë zgjidhjeje në rast se mësuesi vlerësohet negativisht nga ana e Komisionit për vlerësimin psikosocial të punonjësve arsimorë).

Komisioni i Vlerësimit në ZVAP do të vijojë me procedurën e duhur ligjore për plotësimin e vendeve të punës, sipas Udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë” i ndryshuar.

Kandidatët e interesuar jashtë portalit, që plotësojnë kërkesat për pozicionin e mësuesit si më sipër, të paraqesin dokumentat përkatëse pranë ZVAP Finiq-Dropull nga dt. **19.09.2023 ora 10:00 deri më dt 20.09.2023 ora 10:00**, për trajtim sipas legjislacionit në fuqi nga Komisioni i Vlerësimit të ZVAP.

DREJTORE

Ziso LUCI

